

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 12:09**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**

**Parti Politike: PDSH (z. R. Kthupi)**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite:

- Projektvendimin që lidhet me kompensimin financiar paszgjedhor;
- Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”;
- Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021”;
- Pastaj kemi në rradhë çështje që lidhen me shqyrtime administrative të ndryshme, për veprimtari të institucioneve publike gjatë zgjedhjeve të datës 14 Maj 2023;
- Kemi një denocim të Organizatës Qëndresa Qytetare për zgjedhjet e fundit në Bashkinë e Kukësit; dhe,

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

- Dy denoncime nga deputetia zonja Albana Vokshi, po për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator të këtij viti.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me kompensimin financiar paszgjedhor që do t'u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**Z. Y. Merkaç:** Faleminderit! Referuar nenit 89, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, ju kompenson subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, fondet me shumën që rezulton nga shumëzimi i votave të vlefshme të marra prej tyre me vlerën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 88, të Kodit Zgjedhor. Komisioni Rregullator me vendimin nr. 27/2023, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023, duke përcaktuar dhe subjektet zgjedhore që kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme. Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimi nr. 727, ka përcaktuar vlerën në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023 duke përcaktuar se vlera në para e një vote të vlefshme është 80.47 lekë. Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara kemi përgatitur projektvendimin e mësipërm. Qëllimi i këtij projektvendimi është kompensimi financiar paszgjedhor për ato subjekte zgjedhore, të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve paradhënie, partive pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023 dhe kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Komisioni Rregullator me vendimin nr. 27, ka përcaktuar subjektet zgjedhore që kanë përfituar jo më pak se 1 % të votave të vlefshme, që janë:

1. “Partia Socialiste e Shqipërisë”;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

2. Koalicioni “Bashkë Fitojmë”;
3. “Partia Demokratike”;
4. “Partia Socialdemokrate”;
5. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”;
6. “Partia Republikane Shqiptare”;
7. “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”;
8. “Partia Lëvizja e Legalitetit”;
9. “Aleanca Progresiste L.ZH.K”;
10. “Partia Demokracia Sociale”;
11. “Fryma e Re Demokratike”;
12. “Aleanca Liberale e Djathtë”;
13. “Partia e Gjelbër”;

Me Vendimin nr. 30/2023 të Kuvendit të Shqipërisë është përcaktuar se fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, është 100.000.000 (njëqind milion) lekë, i cili me vendimin nr. 397/2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u është shpërndarë si paradhënie partive politike si më poshtë:

- “Partia Demokratike”;
- “Partia Republikane”;
- “Aleanca Progresiste” L.ZH.K;
- “Partia Socialiste e Shqipërisë”;
- “Partia e Lirisë”;
- “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”;
- “Partia Fryma e Re Demokratike”;
- “Partia Demokracia Sociale”;
- “Partia Socialdemokrate”;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

- “Bindja Demokratike”;
- “Partia e Gjelbër”;
- “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”;
- “Partia Aleanca Arbnore Kombëtare”;
- “Partia Uniteti Kombëtar”.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë jo më pak se 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi, janë si më poshtë:

- “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” që ka marrë 3.28%;
- “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka marrë 1.76%;
- “Partia Aleanca Liberale e Djathtë” ka marrë 1.25%.

Në bazë të vendimit nr. 727/2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku përcaktohet se vlera në para e një vote, shuma totale që përfiton si kompensim financiar paszgjedhor secili subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhje dhe nuk ka përfituar fonde paradhënie, dhe ka marrë jo më pak se 1 % të votave është si më poshtë vijon:

- “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë” ka marrë 44.047 vota, shumëzuar me vlerën e një vote merr 3.544.462 lekë;
- “Partia Lëvizja e Legalitetit” ka marrë 23.683 vota dhe përfiton 1.905.771 lekë;
- “Partia Aleanca Liberale e Djathtë” ka marrë 16.859 dhe përfiton 1.356.644 lekë.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësues të Partive politike?! S’kemi! Mirë atëherë, të drejtën për të përfituar kompensim financiar paszgjedhor për zgjedhjet e 14 majit 2023, bazuar në rezultatin e marrë kanë:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

- “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” e cila do të përfitojë 3.544.462 lekë;
- “Partia Lëvizja e Legalitetit” 1.905.771 lekë;
- “Aleanca Liberale e Djathtë” 1.356.644 lekë.

**Vendimi nr. 793**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 12:15**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**

**Parti Politike: PDSH (z. R. Kthupi)**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, projektvendimi që ka të bëjë me miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022.

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Neni 94, pikat 5, e 9, të Kodit Zgjedhor që bën fjalën për fushatën zgjedhore në radiot e televizionet private, përcaktojnë kohën e përgjithshme në televizione të transmetimit të reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore e cila nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. Radiot, televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës t’jua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore...

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*


Ju bëj me dije se kanë ardhur disa rekomandime nga KRIIK-u në orën 11:48 të cilat janë për këtë pikë dhe pikën e tretë të rendit të ditës. Ndoshta është më mirë ta shtyjmë?

**Z. I. Celibashi:** Edhe për pikën tjetër që ka të bëjë me raportin e gjetjeve të vitit 2021?

**Z. Y. Merkaç:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, do t'i shtyjmë këto të dyja, që të kemi kohë të bëjmë një vlerësim të atyre konsideratave të KRIIK në lidhje me këto dy projektvendime, dakord!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 374 ID, të z. Ivi Kaso, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë ndaj Kandidatit për kryetar të Bashkisë Librazhd, Zyrës Vendore Arsimore Librazhd, Drejtorit të shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafit KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar**

**Z. Fatmir Duro, përfaqësues i ZVAP, Librazhd**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, vazhdojmë me shqyrtimet administrative. Kemi denoncimin me numër 374 nga zoti Ivi Kaso, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Librazhd dhe Zyrës Vendore Arsimore Librazhd, një relativ shumë të shkurtër për këtë çështje!

**Znj. M. Koja:** Është administruar denoncimi i bërë nga zoti Ivi Kaso, ndaj zotit Mariglen Disha kandidatit për kryetar bashkie në Bashkinë Librazhd, i subjektit zgjedhor PS, Zyra Vendore Arsimore Librazhd dhe drejtori i Shkollës 9-vjeçare Spathar zoti Qamil Mema. Ne kemi thirrur sot palët për t’i dëgjuar, konkretisht bëhet fjalë për një veprimtari të zhvilluar në ambjentet e jashtme. Konkretisht në murin

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

rrethues të oborrit të shkollës 9-vjeçare, Spathar ku ka marrë pjesë kandidati për kryetar bashkie dhe të tjerë votues dhe zgjedhës. Ne kemi zhvilluar hetimin administrativ. Kemi administruar vërtetimin e Zyrës Vendore Arsimore, Librazhd, ku ata shprehen se kjo është një shkollë në varësi të shkollës 9-vjeçare Spathar, shkolla Gurakuqe. Nga kandidati për kryetar bashkie është zhvilluar veprimtaria. Takimi është zhvilluar në orë të pasdites, pa dijeninë e ZVA Librazhd. Rezulton se nuk ka pjesëmarrje të stafit të shkollës, apo nxënësve në këtë takim. Institucioni arsimor, argumentojnë ata, është larg qendrës së fshatit dhe për ruajtjen e ambientit kujdesen vetë ata, pra nuk ka një roje për ruajtjen e ambienteve të jashtme. Ky ambient edhe pse ka rrethim nuk është i mbyllur, gjithkush mund ta aksesojë atë. Njëkohësisht shprehen se nuk kanë as njoftim, as informacion për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, ndonjë përfaqësues nga Zyra Vendore Arsimore?

**Z. Fatmir Duro, përfaqësues i ZVAP, Librazhd:** Po, Fatmir Duro nga ZVAP, Librazhd. I nderuar Komisioner, ne i qëndrojmë pretendimeve tona të paraqitura në diskutimin përfundimtar, të cilin e kemi shoqëruar dhe me provat përkatëse. Shkurtimisht dua të them që ky është një aktivitet i zhvilluar pa dijeninë tonë, edhe sikur të na vinin në dijeni nuk do të merrnin një leje, por është bërë edhe pa dijeninë e drejtuesit të institucionit arsimor. Ky aktivitet është zhvilluar ditë të shtunë, ditë pushimi dhe për administratën e shkollës. Njëkohësisht duhet të theksojmë faktin që këtu nuk ka pjesëmarrës, siç pretendon Partia Demokratike që “janë shfrytëzuar burimet materiale, apo njerëzore”, pasi nuk ka mësues, apo nxënës të kësaj shkolle. Fakti është që shkolla, pavarësisht se është e rrethuar nuk mbyllet me çelës, pasi është një shkollë larg qendrës së fshatit, është shkollë vartëse që i themi, gjithsej me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

12 nxënës dhe dy mësues. Ne nuk jemi dakord me ankimin që ka paraqitur subjekti politik Partia Demokratike, në lidhje me... pasi nuk ishte përgjegjësia jonë dhe as e drejtuesit të institucionit arsimor, në lidhje me këtë aktivitet. Nga fotot del që ai aktivitet është zhvilluar në orët e vona të pasdites si dhe ditë pushimi, ju faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Kemi ndonjë koment tjetër në lidhje me këtë?

**Znj. M. Koja:** Jo, nuk e provojmë dot ekzaktësisht.

**Z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar:** Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar. Qëndrojnë të gjitha ato që tha përfaqësuesi i zyrës arsimore. Shkolla qendër nga shkolla ku është zhvilluar aktiviteti është rreth 4 km, në një lagje. Shkolla aktualisht me dokumentacionin që kanë çuar ka qenë e mbyllur, kanë qenë orë të vona të pasdites. Pjestarë të stafit nuk kanë qenë prezent. Ju bëj me dije që ne si institucion jemi informuar nga zyra vendore që të mos zhvillohen., pra, e njohim ligjin zgjedhor dhe i është bërë me dije gjithë stafit që nuk duhet të marrin pjesë, sidomos gjatë periudhës së mësimit deri në orën 14:00. Në atë takim nuk ka pas as mësues. Ç'është e vërteta, unë e kam marrë vesh shumë vonë për këtë veprimtari që është kryer në shkollën vartëse Gurëkuqe, ditë të shtunë. Ndjesë për shqetësimin dhe ju premtoj që në të ardhmen nuk do të ketë probleme të tilla.

**Z. I. Celibashi:** Premtimi më i mirë është që të ruash më mirë shkollën, se për atë the që nuk ke ndonjë përgjegjësi. Për aktivitetin the që nuk ke as dijani, as...

**Z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar:** Jo nuk kemi pas dijani që...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*


**Z. I. Celibashi:** Ju aty banoni?

**Z. Qamil Mema, drejtor i shkollës 9-vjeçare Spathar:** Jo, në Librazhd.

**Z. I. Celibashi:** Kemi gjë tjetër? Nuk kemi! Mirë faleminderit për prezencën tuaj, është shumë e vlerësuar nga ana jonë si institucion dhe për kontributin me shpjegimet tuaja. Në vlerësim dhe të asaj çfarë ju thatë, po dhe të gjithë dokumentacionit që ne kemi, mendoj që nuk ka asnjë arsye për të vendosur sanksion administrativ ndaj si drejtuesit të Zyrës Vendore Arsimore Librazhd, po ashtu dhe drejtorit të Shkollës 9-vjeçare Spathar, Librazhd, pasi është evidente që nuk mund të provohet kontributi i tyre në shkelje të ligjit në lidhje me aktivitetin e zhvilluar. Tejkësaj duke i besuar dhe rrëfimit të tyre të sinqertë në lidhje me këtë çështje, po duke parë atë që është më e rëndësishme rrethanat në të cilat është zhvilluar ky aktivitet. Gjithsesi një gjë për ju drejtor, në ambjentet e shkollës, në çdo orë të ditës, të natës të themi në kuptimin figurativ, nuk është e lejueshme të zhvillohet asnjë lloj aktiviteti. Ky ndalim nuk është vetëm për orarin kur aty zhvillohet mësim, apo për ditët kur zhvillohet mësim, po gjatë gjithë periudhës. Gjatë gjithë kohës nuk duhet të zhvillohet aktivitet politik, elektoral në ambientet shkollore.

**Vendimi nr. 794**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 390 ID, të zotit Edmond Spaho, deputet i Kuvendit të Shqipërisë ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Maliq, dhe disa prej punonjësve të administratës së Bashkisë Maliq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaç, znj. M. Koja, z. K. Puleri**


**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, kalojmë te shqyrtimi administrativ që lidhet me denoncimin me numër 390 ID.

**Znj. M. Koja:** Është denoncim i bërë nga zoti Edmond Spaho. Subjekte të denoncuar janë zoti Gëzim Topçiu, kandidati për kryetar bashkie dhe kryetari në atë kohë i Bashkisë Maliq dhe disa punonjës të administratës së Bashkisë Maliq. Bëhet fjalë për një veprimtari elektorale të zhvilluar në datën 2 maj, me prani të kryeministrit dhe disa funksionarë të tjerë të qeverisë. Nga denoncuesi pretendohet se në këtë aktivitet kanë marrë pjesë tetë punonjës të Bashkisë Maliq. Nga hetimi administrativ rezulton se për tetë persona bëhet fjalë që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet, një pjesë e tyre siç kanë provuar dhe me dokumentacion provues kanë qenë duke

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

konsumuar lejen vjetore. Ndërsa të tjerët janë funksionarë politik, shprehet në pretendimin e saj Bashkia Maliq. Konkretisht nënkryetar bashkie, po dhe funksionarë të tjerë administratorë të njësive vendore. Nuk di nëse ka ardhur ndonjë përfaqësues?! Ne i kemi thirrur në fakt për të qenë prezent këtu. Është një veprimtari elektorale dhe nuk është një veprimtari publike. Pra, nuk ka pas detyrim për raportim në ndërfaqen e KQZ-së.

**Z. I. Celibashi:** Kush është pretendimi, tani?

**Znj. M. Koja:** Që punonjësit e bashkisë kanë marrë pjesë në një aktivitet elektorale brenda orarit zyrtar, pra në orën 14:30.

**Z. I. Celibashi:** Kërkohet sanksion për këta punonjës bashkie?

**Znj. M. Koja:** Po, për punonjësit e bashkisë, po një pjesë e tyre rezulton të ketë qenë me lejen vjetore, pra në bindjen tonë përjashtohen. Ndërkohë janë fotot të vëna të dispozicion të një personi që ecën në rrugë, po nuk e lidhim detyrimisht personin me veprimtarinë në një prej rasteve, të denoncuar. Në këto kushte e kemi pas të vështirë të provojmë lidhjen ndërmjet fotove dhe provave të vëna në dispozicion dhe aktivitetit të zhvilluar.

**Z. I. Celibashi:** Ka ndonjë përfaqësues, qoftë të denoncuesit..? Jo, nuk ka! Prova të tjera përveç atyre që janë paraqitur?

**Znj. M. Koja:** Jo nuk kemi!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, meqenëse këto pretendime, për aq sa përmbajnë provat që kanë bashkëshoqëruar këtë denoncim, nuk mund ta provojnë këtë si pretendim, edhe këtë denoncim do ta mbyllim pa sanksion.

**Vendimi nr. 794**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 12:27**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 417 ID, të zotit Edmond Spaho, deputet i Kuvendit të Shqipërisë ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Maliq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**


**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, kalojmë te shqyrtimi administrativ që lidhet me denoncimin me numër 417 ID, po të deputetit Spaho.

**Znj. M. Koja:** Është sërish denoncim i bërë nga zoti Edmond Spaho. Përsëri ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Maliq, subjektit zgjedhor zotit Gëzim Topçiu. Bëhet fjalë për zhvillim veprimtarie të ndaluar me vendimmarrje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këto kanë qenë, në fakt, veprimtari të raportuara në ndërfaqe, por Komisioneri ka ndërhyrë atëherë me vendim për t’i ndaluar për shkak të mos respektimit të afatit të njoftimit. Janë njoftuar jo para pesë ditë që do të zhvillohej veprimtaria. I janë njoftuar vendimmarrjet e Komisionerit si personit përgjegjës dhe ai provon që ka komunikuar dhe kryetarin e bashkisë. Megjithatë konstatohet se veprimtaritë janë zhvilluar, pavarësisht ndalimit nga Komisioneri.

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

Ata pretendojnë se “këto veprimtari ne i kemi zhvilluar dhe i kemi trajtuar më pas si takime elektorale dhe jo më si veprimtari publike të institucionit të bashkisë”. Pra, ky është pretendimi që ka Bashkia Maliq. Janë zhvilluar veprimtaritë, po nuk kanë qenë tematika si: inspektim punimesh, apo takim pune me banorë. Kanë qenë me natyrë elektorale. Ky është pretendimi i bashkisë.

**Z. I. Celibashi:** Kush ka marrë pjesë në këtë aktivitet?

**Znj. M. Koja:** Kanë qenë banorë të njësive administrative...


**Z. I. Celibashi:** Jo, jo, në cilësinë e organizatorit, të njejtët kanë qenë?

**Znj. M. Koja:** Kandidati dhe njëkohësisht kryetari i bashkisë, por thotë që “kanë qenë takime elektorale, jo në funksionin e kryetarit të bashkisë, por kam qenë si kandidat”.

**Z. I. Celibashi:** Nëse është urdhëruar për të mos e zhvilluar atë aktivitet dhe e ka zhvilluar duke thënë që “shiko po e zhvilloj aktivitetin duke shfrytëzuar të njejtën orë dhe të njejtin ambient”, atëherë mendoj që të propozojmë vendosjen e një sanksioni. Do të duhej, të paktën dhe formalisht, ta zhvillonte qoftë dhe një minutë më vonë, atë aktivitet. Nëse bëhet fjalë për të njejtin aktivitet.

**Znj. M. Koja:** Ata e kanë pohuar, pavarësisht se thonë që kemi marrë njoftim dhe tashmë e kemi zhvilluar si veprimtari elektorale dhe jo publike.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Po, për këtë rast do të vendosim sanksion dhe në të ardhmen duhet ta kemi në vëmendje që ai aktivitet që vendoset të anulohet, ata nuk mund ta zhvillojnë në të njejtën ditë, orë dhe me të njejtin format edhe pse mundet ta konsiderojnë dhe vërtet ndoshta mundet të jetë ashtu, si aktivitet politik dhe elektoral pa qenë nevoja ta raportojnë.

**Vendimi nr. 795**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 12:31**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 413 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, Zyrës Vendore Arsimore Malësi e Madhe, drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, Malësi e Madhe, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin administrativ të lidhur me denoncimin me numër 413 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe, Zyrës Vendore Arsimore Has, drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, Malësi e Madhe.

**Znj. M. Koja:** Është denoncim i Qëndresës ndaj subjektit që ju cituat, zoti Komisioner. Objekt denoncimi është zhvillimi i një veprimtarie elektorale në datën 3 maj 2023, në ambientet e jashtme të Shkollës 9-vjeçare “Fran Murrizi”, në Pjetroschan. Takimi është ndërmjet kandidatit të Partisë Socialiste për kryetar të Bashkisë Malësi e Madhe dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton nga pamjet filmike, kandidati e ka zhvilluar këtë aktivitet në ambientet e shkollës. Është zhvilluar hetimi administrativ edhe për këtë rast. Bashkia Malësi e Madhe pohon se është zhvilluar

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

në ambientet e jashtme të shkollës, aktiviteti. Ata argumentojnë që për shkak të një konflikti të ndodhur me disa banorë përreth shkollës, aty ku kanë qenë duke e zhvilluar fillimisht aktivitetin, për pretendime në lidhje me pronësinë në sheshin e jashtëm, në oborrin e shkollës, kanë qenë të detyruar nga situata, për t'u futur në oborrin e shkollës dhe për ta vijuar aty më tej aktivitetin. Këto janë pretendimet e bashkisë.


**Z. I. Celibashi:** Dakord, përfaqësuesi i Qëndresës?

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Përshëndetje!

**Z. I. Celibashi:** Nëse keni diçka më shumë për të shtuar?

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Jo nuk kemi për të shtuar diçka më shumë, thjesht i qëndrojmë denoncimit të bërë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sepse është e qartë që është zhvilluar në një shkollë 9-vjeçare, si Shkolla "Fran Murrizi". Pavarësisht pretendimeve që mund të ketë kryetari i bashkisë, ose kandidati i Partisë Socialiste, asgjë nuk qëndron. Ligji është mjaft i qartë, parashikon dhe ndalon vënien në përdorim të burimeve publike sië janë edhe shkollat, për të zhvilluar aktivitete politike dhe elektorale. Është e qartë që është një aktivitet elektorale, sepse provohet edhe nga thirrjet, por edhe nga mënyra se si vetë kandidati, Beqir Mulaj e ka reklamuar këtë aktivitet në faqen e tij zyrtare, por dhe në faqen e Partisë Socialiste. Kërkojmë sanksionimin e tij dhe të drejtorit të shkollës, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Kemi përfaqësues nga...? Jo nuk kemi! Mirë, atëherë për këtë rast vlerësojmë se pretendimet dhe denoncimi i Organizatës “Qëndresa Qytetare” qëndron, pasi është e dukshme që ai aktivitet është zhvilluar në ato ambiente. Tej shkakut apo rrethanave që kanë imponuar zhvillimin e atij aktiviteti në atë ambient, edhe nëse është kjo situata, duke e marrë të mirqenë që kjo është situata e atij incidenti, do të duhej të mos e kishin zhvilluar. Kjo nuk përbën justifikim ligjor. Kështu që për personat përgjegjës do të propozojmë për të vendosur sanksion administrativ.

**Vendimi nr. 796**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 12:34**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 412 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Has, Zyrës Vendore Arsimore Has, drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Has për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**

**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin administrativ të lidhur me denoncimin me numër 412 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare”.

**Znj. M. Koja:** Është denoncim sërish i Organizatës “Qëndresa Qytetare” kundër zotit Beqir Mulaj, kandidat për kryetar bashkie i subjektit PS, Zyra Vendore Arsimore, Has dhe drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has. Jemi në një situatë të ngjashme, në datën 5 maj 2023, në ambientet e Shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, në fshatin Helshan, është zhvilluar takim mes kandidatit për kryetar bashkie dhe banorëve. Kjo e provuar nga postimet në faqen e kandidatit. Zyra Vendore Arsimore Has, pretendon që aktiviteti është zhvilluar jashtë procesit mësimor, në orën 16:30, brenda oborrit të shkollës. Nuk janë përdorur materialet e

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

shkollës në mbështetje të aktivitetit. Është zhvilluar ky aktivitet pa dijeninë e drejtuesit të shkollës e cila nuk është njoftuar nga ana e organizatorëve dhe nuk është kërkuar as leje për zhvillimin e saj. Cilësohet që shkolla është e rrethuar po portat e jashtme nuk janë të kyçura, gjithkush mund ta aksesojë. Këto janë vetëm prapësimet që ka sjellë Zyra Vendore Arsimore, Has. Rezulton e provuar që është bërë ky aktivitet në Shkollën 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has. Qëndresa nëse ka ndonjë pretendim tjetër!

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** I qëndrojmë thelbit për zotën Tonin Morina, edhe për zotën Beqir Mulaj është e njejta situatë. Jemi në ambientet e shkollës 9-vjeçare, pak rëndësi ka. Ligji nuk nuk parashikon faktin që jemi jashtë orarit mësimor, për çdo rast duhet ndaluar dhe ambientet e shkollave nuk mund të përdoren si vende për të zhvilluar tubime elektorale dhe për të fituar mbështetjen e qytetarëve dhe votuesve. Kështu që për të njejtin arësyetim, pavarësisht faktit që shkolla nuk është e rrethuar., shkolla është e rrethuar, por siç e pranojnë ata vetë që shkolla nuk ka kyç, as roje sigurie. Vetë bashkia duhet ta dijë ligjin shumë mirë dhe duhet të jetë bindur pavarësisht se është e rrethuar apo jo, nuk përbën fakt pengues për ta ndëshkuar administrativisht, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Ka përfaqësues? Nuk ka! Dakord! Është evidente që ai takim nuk do të duhej të ishte zhvilluar. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë dhe përgjegjësinë e atyre që do të duhej në mënyrë institucionale të pengonin zhvillimin e aktivitetit. Më duket se e kemi të vështirë të provojmë mbi dijeninë, qoftë të drejtorit të shkollës, qoftë dhe mbi çfarë u relatua. Unë jam vërtet drejtor i shkollës dhe nëse në ambientin e shkollës ku unë jam drejtor zhvillohet një aktivitet jashtë dijenisë time, nuk mendoj se në këtë rast ka përgjegjësi drejtori, apo të themi

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

drejtuesit e zyrës vendore. Kemi qoftë dhe një indicie që këta kanë qenë në dijeni të zhvillimit të këtij aktiviteti? Tejt asaj që argumenti, sikurse ju e thatë, që është zhvilluar jashtë orarit, nuk qëndron, sepse e thamë atë, në çdo orë, e në çdo moment të ditës nuk mund të zhvillohen aktivitete politike elektorale në ambientet e shkollës. Nëse ai që është përgjegjës për ta garantuar këtë rregull është jashtë dijenisë, nuk mendoj që... se nuk me duket si rasti i parë që ata e kanë pranuar “e bëjnë sepse ndodhi kjo...” dhe kanë qenë në një lloj dijenie. Në këtë rast...


**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Edhe në rastin konkret, dakord për drejtuesit e shkollës nuk mund ta pranoj dijeninë e tyre, por mund të provohet dijenia e kandidatit të Partisë Socialiste, e subjektit zgjedhor, në referim të nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Mund të provohet dijenia e këtyre subjekteve për këtë shkelje. Faktin që po organizojn një aktivitet në një shkollë. Mendoj se në rast se nuk marrim vendim për ndëshkimin administrativisht të drejtorit të Shkollës “Sali Hajdari”, duhet të merret me patjetër, masë administrative gjorbë, ndaj kandidatit të Partisë Socialiste, sepse e ka shkelur ligjin.

**Z. I. Celibashi:** Dakord!

**Znj. M. Koja:** Është vetëm kandidat, jo kryetar.

**Z. I. Celibashi:** Nuk është kryetar bashkie! Në fakt, qoftë Kodi Zgjedhor, qoftë vendimi nr. 9 i Rregullatorit, nuk ka një përcaktim për këtë rast. Megjithatë le ta vlerësojmë këtë edhe njëherë. Si të thuash legjitimitetin e kërkesës për të sanksionuar kandidatit për kryetar bashkie. Edhe pse qëllimi i këtyre dispozitave të Kodit Zgjedhor për këtë natyrë shkeljesh, apo dhe i vendimit nr. 9 të Komisionit

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

Rregullator ka të bëjë me përgjegjësinë e institucioneve publike në lidhje me administrimin e aseteve publike. Këtë do ta vlerësojmë dhe do të shpallim vendimin në një ditë tjetër. Pra, për pikën nr. 7, denoncimin me nr. 412.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

6.10.2023  
Ora 12:40

**RENDI I DITËS**

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 402 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Instuticione të Konsoliduara, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Kamëz për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)

**Z. I. Celibashi:** Shkojmë te denocimi që lidhet me shqyrtimin administrativ me numër 402 ID.

**Znj. M. Koja:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Instuticione të Konsoliduara, subjekti i denoncuar është sekretari i përgjithshëm për Bashkinë Kamëz, zoti Elvis Gjika. Bëhet fjalë për një veprimtari “Kamza Lexon”, është një veprimtari publike e organizuar nga Bashkia Kamëz. Është një aktivitet i zhvilluar me disa të pranishëm, me disa përfaqësues nga bota politike, diplomatë, shkrimtarë, gazetarë. Në fakt është veprimtari e cila është raportuar në ndërfaqen e KQZ, por pavarësisht kësaj, denoncuesi pretendon që janë zhvilluar dy veprimtari. Ndërsa Bashkia Kamëz argumenton se është një veprimtari dhe sipas Bashkisë Kamëz është e paqartë nga ana e denoncuesit për cilën veprimtari ka denoncuar. Bashkia pretendon se e ka

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

raportuar dhe ne konfirmojmë se e ka raportuar. Ata pretendojnë që e “kemi shtyrë veprimtarinë dhe është zhvilluar në një ditë tjetër, por është veprimtaria të cilën ne e kemi raportuar”.

**Z. I. Celibashi:** Dmth e kanë raportuar veprimtarinë “x”, që do të zhvillohej në datën “y”. Nuk është zhvilluar veprimtaria “x”, në datën “y”, por është zhvilluar e njejta veprimtari në një datë tjetër.

**Znj. M. Koja:** Po, është e njejta veprimtari sipas pretendimeve të bashkisë.

**Z. I. Celibashi:** Por është zhvilluar në ditë tjetër?

**Znj. M. Koja:** Po, në ditë tjetër!

**Z. I. Celibashi:** Ka përfaqësues nga bashkia? Nuk ka! Në vlerësimin tim do të duhej që ta kishin riraportuar atë si veprimtari, sepse është një veprimtari tjetër. Ti ke raportuar për atë veprimtari në atë datë dhe ne ndjekim dhe monitorojmë atë veprimtari të cilën e ke raportuar. Nuk e zhvillove do të thotë që nuk është zhvilluar ajo veprimtari. Zhvillimi i saj në një ditë tjetër implikon angazhime të tjera, ndoshta dhe qëllime të tjera. Kështu që edhe pse ata, ndoshta deri diku në mënyrë të justifikuar kanë konsideruar se nuk ka qenë nevoja për ta raportuar. Se kështu i bie që e ka raportuar që në fillim të vitit dhe mendon se e ka raportuar, pavarësisht se e zhvillon në datën e deklaruar se kur do të zhvillohej aktiviteti. Në këtë rast do të propozojmë vendosjen e një sanksioni administrativ në minimum, duke parë dhe rrethanën justifikuese. Gjithsesi në thelb ky pretendim nuk qëndron.

**Vendimi nr. 797**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

6.10.2023  
Ora 12:44

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 409 ID, të Organizatës “Drejtësia Sociale, ndaj personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në “Ministrinë e Kulturës, Bashkinë Tiranë, Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Eksperimental, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafii KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)

OJF “Drejtësia Sociale”, (znj. Gjyljana Bakalli)

TKOBAP (znj. Greta Gjinaj, znj. Migena Biba)

**Z. I. Celibashi:** Pika 10, shqyrtimi administrativ që lidhet me denoncimin 409 ID, i Organizatës “Drejtësia Sociale”.

**Znj. M. Koja:** Organizata “Drejtësia Sociale”, denoncues në rastin konkret, denoncon një veprimtari të zhvilluar në datën 4 maj, në orën 16:30. Takim ky i zhvilluar në mjediset e hollit të Teatrit Kombëtar, me pjesëmarrës nga Ministria e Kulturës, kryetari i Bashkisë Tiranë, Teatri Eksperimental, drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia-studio “Kadare”, Galeria e Arteve Tiranë, etj. Sipas denoncuesit ky është një aktivitet në kuadër të fushatës për zgjedhjet vendore, në një ambient

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

kulturor në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe po përdoret në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej se kush është organizatori i veprimtarisë, nëse është Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, apo muzeu në rastin konkret. Në këto kushte, kjo është një veprimtari e cila është më natyrë institucionale, pjesëmarrja e përfaqësuesve nga ministria, apo dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë është në funksion të detyrave të tyre funksionale. Është veprimtari që ka pas detyrim të raportohet dhe nuk rezulton të jetë raportuar. Mbetet e paqartë se kush është institucioni mbi të cilin bie përgjegjësia për të raportuar.

**Z. I. Celibashi:** Ka ndonjë përfaqësues nga organizata?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Përshëndetje, Gjyljana Bakalli. Nga zbardhja që është bërë nga takimi që është dhe video e hedhur në facebook nga ana e ministres së kulturës, janë bërë premtime elektorale. Janë përmendur edhe punë që janë bërë, kështu që nuk mendoj se është takim institucional duke qenë se ka qenë dhe në orar pune dhe janë prezent edhe drejtuesit e institucioneve. Sërisht në median sociale të ministres janë të pasqyruara eventet dhe ka thënë që “do të kthejmë bienalen, do të ndërtohet Muzeu i Artit Modern, do të vazhdojë ndërtimi i Teatrit Kombëtar..”. Pra, janë premtime elektorale. Mendoj se është veprimtari e ndaluar dhe është kryer duke shfrytëzuar një institucion publik që është hollit i Teatrit të Operas dhe Baletit, jo i Teatrit Kombëtar siç u citua, por TOBAP. Është dhe me foto, vijojnë të jenë publike në rrjetet sociale të ministres, sepse nga bashkia nuk e kemi gjetur, është dhe me video. Kështu që i qëndrojmë pretendimit që është veprimtari e ndaluar dhe personat përgjegjës, pavarësisht kush është organizator... dhe për ne është e qartë që e organizon Bashkia Tiranë, sepse është event që u zhvillua për shkak të fushatës dhe zhvillohet në Tiranë. Duke qenë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

se dhe ministria zotohet bashkë me Erjon Velian, kryetarin aktual të bashkisë. I qëndrojmë pretendimit që është veprimtari e ndaluar dhe duhet të ketë sanksion administrativ për të dy personat për të cilët ne kemi ngritur pretendime, faleminderit.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit!

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Jam Migena Biba, juriste e institucionit dhe Greta Gjinaj, specialiste e promocionit në TKOBAP. Të dyja jemi të përfaqësuara me autorizim. Ne jemi njohur me e-mail në datën 11 maj që ka ardhur në institucion, po zoti Kryetar, mendojmë se nuk legjitimohemi në këtë proces, në këtë denoncim, sepse ne jemi Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor. Ndërsa në e-mail është referuar Ministria e Kulturës, Bashkia Tiranë, Teatri Kombëtar, Teatri Eksperimental. Gjithsesi në bazë të ligjit tonë organik për artin dhe kulturën, institucioni TKOBAP është një institucion publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Gjithsesi, referuar e-mail që keni dërguar në datën 4 maj, ora 16:30, ministria e kulturës dhe kryetari i Bashkisë Tiranë, citoni ndër të tjera që “kanë zhvilluar një takim në mjediset e hollit të Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental, në varësi të Bashkisë Tiranë, si drejtues të Teatrit të Metropolit, Shtëpia-studio “Kadare”, Galeria e Artit Tiranë”. Asnjë nga këto institucione që ju keni cituar nuk ka të bëjë me institucionin tonë, e para. Ajo që është më e rëndësishme në datën 4 maj, janë zhvilluar dy aktivitete të cilat ne i kemi dhe të provuara dhe me dokumentacion. Një prej tyre është... kemi bërë një kontratë qeraje në bazë të kërkesës që ka sjellë subjekti pranë institucionit tonë dhe tjetri është koncerti i maestros Armando Kllogjeri. Këto ne mund t’i depozitojmë pranë Komisionerit. Gjithashtu nga Ministria e Kulturës, sot më është dërguar dhe një informacion që e kishim të pamundur për të ardhur dhe paraqitur në seancë, por kanë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

dorëzuar një e-mail, ku sqarojnë dhe pozitën e tyre. I nderuar Kryetar, duke qenë se ne nuk legjitimohemi në proces, jemi një institucion i ndryshëm nga sa denoncon shoqëria, si dhe në atë datë nuk janë zhvilluar aktivitete për të cilat ata pretendojnë, por janë zhvilluar dy aktivitete të cilat janë në kuadër të veprimtarisë sonë institucionale, mendojmë që kërkesa nuk duhet të merret parasysht. Faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Kishit diçka tjetër?

**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Po, edhe diçka! Kontrata e qerasë ka qenë me një gjerman, kam koorespondencën nëpërmjet e-mail, që ka nisur që në datën 21 mars 2023, pasi unë bëj dhe asistenten e drejtorit të përgjithshëm dhe jam personi përgjegjës e cila kam raportuar çdo aktivitet përgjatë periudhës para zgjedhore. Nisur nga e-mail, kam nga Eneo Protopapa, i cili ishte personi përgjegjës i Fred Rikebertinfung, ka ardhur e-mail që në datën 4 maj të kërkonin hollin e katit të dytë koncertor, nga ora 18:45 deri në orën 20:45. Për efekt kohe, në atë periudhë salla, pra në 4 maj, ishte e lirë dhe ata kërkuan që të paktën minimumi dy orë para aktivitetit, sepse ishte ekspozitë, donin të bënin montim të ledwoll-it, që do të thotë që ata janë futur në orën 17:00 dhe e kanë marrë hollin tre orë me qera. Gjithashtu vlen të theksohet se në orën 19:30, ata kanë dalë jashtë, për arsye se do të niste koncerti “Troket folk”, nga maestro Kllogjeri, të cilat vërtetohen shumë lehtë nga mediat tona sociale, ku kemi banerin. Pra, janë dy aktivitete që kemi pas atë ditë pasdite, të cilat nuk rakordojnë me atë që na kanë denoncuar për hollin dhe skenën e TKOBAP.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Jeni duke thënë që “aktiviteti i denoncuar nga ana e Organizatës “Drejtësia Sociale”, nuk është zhvilluar në ambientet tuaja”, me sa kuptoj unë?! Këtë jeni duke thënë!

**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Po sipas datës që ata na referohen. Data 4.05...

**Z. I. Celibashi:** Se në këtë datë, thoni ju, kur pretendohet se është zhvilluar aktiviteti i denoncuar, ju keni pasur aktivitete të tjera në TKOPB?

**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Po, të cilat vërtetohen nga kontrata e qerasë me nr. 316/1, dt.27.03., pra që është lidhur kjo kontratë qeraje.

**Z. I. Celibashi:** Jeni duke thënë që “janë vetëm këto dy aktivitete të zhvilluara në atë datë dhe s’ka asnjë aktivitet tjetër”?!


**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Po, s’ka asnjë aktivitet tjetër.

**Z. I. Celibashi:** Nuk ka qenë ministria e kulturës, dhe...

**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** As Bashkia Tiranë, apo Teatri Kombëtar, Eksperimental, të cilët denoncohen nga ana e shoqatës në datën 4 maj.

**Z. I. Celibashi:** Jo, ju nuk përfaqësoni Teatrën Eksperimental? Po thoni që në ambientet që ju zotëroni si institucion, nuk janë zhvilluar këto dy aktivitete.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Jo! Kemi pas një kontratë qeraje dhe ne kemi një kalendar artistik me të cilin ecim me një bord artistik që është miratuar me datën 22.12.2022 për këto aktivitete.

**Z. I. Celibashi:** E kuptova! Kemi ndonjë gjë për të shtuar?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Më vjen keq që zonjat janë dhe në varësi të ministres, se jeni duke kundërshtuar ministren që... është data 4 maj, është nxjerrë nga facebooku, është live video nga ambientet e TKOBAP. Ne nuk kemi thirrur si palë TKOBAP, sot e mora vesh. Ne kemi kërkuar dhe denoncuar si subjekt ministren dhe kryetarin e bashkisë, ndaj nuk kemi... Ne e kuptojmë që thjesht është bërë një aktivitet, është bërë te hollit në kat të parë. Fatmirësisht, unë jam frekuentuese e atij ambienti dhe e di mirë se si është i organizuar, konkretisht është organizuar në hollin e katit të parë, jo të katit të dytë.

**Z. I. Celibashi:** Ndoshta mos janë dhe data të ndryshme, mbase ka nevojë të shihen datat. Pretendimi juaj është që ky aktivitet është zhvilluar në një prej holleve të TKOBAP, apo jo?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Jo në Teatrin Eksperimental?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Jo, jo! E kemi cituar vendin, por është dhe video live e ministres.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Përfaqësuesit... ose njëra prej palëve gënjen, ose është e pasaktë, pasaktësia mund të lidhet me datën?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Nuk e di si mund të futesh live në facebook një ditë më vonë, po ne kemi pretendimin që ky takim është zhvilluar në ambientet e hollit të TKOBAP. Në vjen shumë keq që as përfaqësuesit e ministrisë dhe as përfaqësuesit e bashkisë nuk kanë bashkëpunuar me ju. As ne nuk kemi një informacion se çfarë ka ndodhur. Ne i qëndrojmë...

**Z. I. Celibashi:** Ata kana sjellë shpjegimet e tyre dhe ministria ka sjellë një shpjegim. Çështja është se sa qëndrojnë ato si pretendime, po tej kësaj, ajo çfarë ju pretendoni është fakti që, veprimtaria nuk është raportuar?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Po!


**Z. I. Celibashi:** Dhe ka qenë veprimtari me karakter politik dhe elektoral?

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Po!

**Z. I. Celibashi:** Nëse është veprimtari me karakter politik dhe elektoral, natyra e shkeljes është tjetër, që do të thotë që në një veprimtari me karakter politiko-elektoral, janë përdorur asetet publike...

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Z. I. Celibashi:** Nëse veprimtaria ka qenë institucionale dhe jo elektorale, pretendimi juaj shkon që të lidhet me mungesën e raportimit të asaj veprimtarie. Pra, do të duhet të jetë ose njëra, ose tjetra. Nëse është veprimtari politike-elektorale nuk ka pas detyrimin askush për ta raportuar, po nëse ka qenë veprimtari institucionale, atëherë është detyrimi për të raportuar. Nëse kjo veprimtari institucionale është katandisur në veprimtari politike dhe elektorale, atëherë ka dhe një shkelje tjetër që lidhet me përdorimin e aseteve publike për qëllime politike dhe elektorale. Ju, i qëndroni pretendimit se në atë datë nuk ka... Po në lidhje me provën që paraqet pala denoncuese sipas të cilës rezulton se janë pamje të marra nga facebook-u i ministres, në datën që ata pretendojnë se është zhvilluar ky aktivitet?

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** I nderuar Kryetar! Ne i qëndrojmë pretendimeve tona. Në datën 4 maj, në ambientet e institucionit të TKOBAP janë zhvilluar dy aktivitete. Njëra, sipas kontratës së qerasë është ekspozitë dhe tjetra ka qenë “Troket Folk”, i maestros Armando Kllogjeri. Këto kanë qenë.

**Z. I. Celibashi:** Kontrata e qerasë nuk presupozon që mund të jetë zhvilluar aktiviteti. Keni ndonjë dokument që e keni zhvilluar aktivitetin në atë datë?

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Po, patjetër!

**Z. I. Celibashi:** Ndonjë foto, ose ndonjë procesverbal, ndonjë ditar?

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Foto, unë nuk kam për momentin, sepse ky është një aktivitet që zhvillohet nga të tretët, por ama kemi një kontratë e cila ka në objekt të saj “çeljen e një ekspozite me foto të sindikatës së punonjësve të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

telekomunikacionit”. Kemi orare të përcaktuara, me çdo gjë. Është një aktivitet që kryhet nga të tretët dhe ne nuk i dokumentojmë. E rëndësishme për instuticionin është që aktiviteti dhe objekti të jetë i ligjshëm, të mos jetë për arsye politike që kemi detyrime të tjera. Nuk kam diçka për momentin, por mund të dokumentohet.

**Z. I. Celibashi:** Mundet, keni diçka që mund ta paraqesni?

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Kam vetëm kontratën e qerasë.

**Z. I. Celibashi:** Jo, veç asaj.

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Veç kësaj, për këtë kontratë nuk kam një dokument për momentin. Ndoshta mund të hapim arkivën që të vërtetojmë që kemi një çelje ekspozite?


**Znj. G. Gjinaj, specialiste promocioni në TKOBAP:** Mund të hapen kamerat. Ne nuk e vërtetojmë dot përveç përfaqësuesit me të cilin kemi kontratën e qerasë.

**Z. I. Celibashi:** Edhe kjo mund të ishte e mjaftueshme “që kemi qenë”!

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Tjetra është Maestro “Troket Folk”. Është aktivitet i kalendarit artistik, miratuar nga Bordi Artistik, është pjesë e instuticionit tonë, nuk është aktivitet për të cilin ju pretendoni.

**Znj. Gj. Bakalli, përfaqësuese e Organizatës “Qëndresa Sociale”:** Kjo është zhvilluar brenda te salla e TKOBAP, ne po flasim për hollin.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**Znj. M. Biba, juriste e TKOBAP:** Zonjë e nderuar, përpara se t'i drejtoheni institucionit tonë, duhet të jeni më të saktë dhe mos shkaktoni rrëmujë. Ju nuk i drejtoheni TKOBAP, po ne përsëri i jemi përgjigjur Komisionerit duke i shpjeguar dhe duke treguar dhe gatishmërinë tonë për të ardhur në këtë seancë, së pari. Pastaj për datën që ju i referoheni, janë vetëm këto dy aktivitete, mos na vendosni në pozita sikur ne po themi diçka të gabuar.

**Z. I. Celibashi:** Këtë e sqaruam, që bëhet fjalë për institucionin tuaj, po ju pretendoni se në atë datë nuk është zhvilluar në institucionin tuaj aktiviteti që pretendon pala denoncuese, e kam të qartë. Keni kontratën e qerasë, por thatë që mund të sillni një dokument shtesë për të provuar këtë. Atëherë, meqenëse kemi të gjithë komoditetin e kohës për ta trajtuar këtë çështje, po ju japim mundësinë që të paraqesni çfarë ju keni shtesë, në mbështetje të asaj çfarë ju thatë sot në lidhje me këtë çështje. Dakord?! Mirë faleminderit! Do t'ju njoftojmë për një ditë tjetër, po ndërkohë ju mund të depozitoni në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duke filluar nga tani e më pas.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

6.10.2023  
Ora 12:59

**RENDI I DITËS**

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 01 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Kukës dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**


**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Mirë, vazhdojmë me shqyrtimin administrativ të lidhur me denoncimin me numër 01 ID, të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, ndaj kandidatit për kryetar të Bashkisë Kukës dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023. Kjo është?

**Znj. M. Koja:** Organizata “Qëndresa Qytetare” ka denoncuar zotin Albert Halilaj, kandidat për kryetar në Bashkinë Kukës si dhe subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Në datën 19 shtator 2023, kandidati i Partisë Socialiste për Bashkinë Kukës, ka postuar një poster në të cilin identifikohen fjalët “Të mërkurën ora 18:30, ju ftojme në takimin përmbyllës elektoral me kandidatit si dhe në koncertin festiv

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

me pjesëmarrjen e disa prej artistëve shqiptarë”. Për këtë çështje ka një vendimmarrje të Komisionerit, paraprakisht dhe u administruan në atë rast provat dhe pretendimet e subjektit që “koncerti festiv, në kuadër të zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor, nuk do të zhvillohet”. Ndërkohë, subjekti denoncues “Qëndresa Qytetare”, konstaton se në fakt koncerti është zhvilluar. Në kuadër të këtij hetimi, janë bërë disa komunikime. Konkretisht me kryetarin në detyrë të Bashkisë Kukës, pra në periudhën para se të merrej mandati, nga kryetari aktual dhe me Drejtorinë e Policisë Vendore Kukës, në lidhje me kërkimin e informacionit për subjektin që ka kërkuar leje për zhvillimin dhe organizimin e koncertit festiv. Deri më tani nuk e kemi administruar përgjigjen. Jemi ende në fazën e shqyrtimit administrativ.

**Z. I. Celibashi:** Përfaqësuesi i Qëndresës në lidhje me këtë çështje?

**Z. Dh. Zguri, përfaqësues i Organizatës “Qëndresa Qytetare”:** Ditën që u shqyrtua këtu paraprakisht ne e dinim që do të zhvillohej një koncert. Partia Socialiste ka deklaruar që ky aktivitet nuk do të bëhej. Megjithatë deri në momentin që ne kemi qenë në KQZ atë ditë, kanë rezultuar të publikuara në faqen e zotit Albert Halilaj, foto të pjesëmarrëse, këngëtarëve praktikisht dhe pjesëmarrës të tjerë të Partisë Socialiste, pamje që lidhen me një poster që është ftesë për takim përmbyllës elektorale të kandidatit dhe koncertin festiv. Më pas ka rezultuar se koncerti është zhvilluar, kjo rezulton dhe nga pamjet që kanë dalë nga rrjetet sociale. Kanë qenë disa foto dhe më pas mund të dallohen dhe kur drejtues, zv.kryeministria Belinda Balluku, apo dhe drejtues të tjerë Pandeli Majko, drejtues të tjerë të Partisë Socialiste dhe funksionarë të lartë politikë kanë marrë pjesë në këtë aktivitet që ka qenë jo vetëm përmbyllja e fushatës për kandidatin, por edhe zhvillimi i një koncerti. Në referim të nenit 78, pikës 9 të tij “subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohej

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*


të organizojnë, kryejnë, apo mbulojnë shpenzimet vetë, apo nëpërmjet të tretëve për koncerte, pavarësisht se ato mbahen përgjatë, ose në lidhje me tubime elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate, ose jashtë saj”. Në rastin konkret, ne mendojmë se edhe në qoftë se nuk është organizuar në mënyrë të drejtë për drejtë nga zoti Albert Halilaj, duke qenë se nuk kemi dhe informacion, sepse nuk kanë denjuar të kthejnë përgjigje, fatkeqësisht. Sërish një veprimtari edhe sikur të jetë nga të tretët, për aq kohë sa është zhvilluar në lidhje me fushatën dhe në lidhje me takimin përmbyllës të fushatës (veçanërisht është zhvilluar në momentin e përfundimit të këtij takimi përmbyllës), ne mendojmë që është shkelur pika 9 e nenit 78 të Kodit Zgjedhor. Në të tilla raste duke referuar nenin 172 që parashikon sanksionet për subjektet zgjedhore, për shkelje të ndalimit të këtij ligji, kërkojmë ndëshkimin e zotit Albert Halilaj, por dhe të Partisë Socialiste si një nga subjektet zgjedhore që ka përfituar nga zhvillimi i këtij aktiviteti.

**Z. I. Celibashi:** Po faleminderit! Ju kemi kërkuar informacion dhe bashkisë edhe...

**Znj. M. Koja:** Policisë Vendore në lidhje me subjektin që ka kërkuar leje për të zhvilluar koncertin.

**Z. I. Celibashi:** Do t’ju dërgojmë edhe një njoftim të dytë, duke ju bërë me dije që në mungesë.., se nuk dua ta përkufizoj si refuzim, të përgjigjes nga ana e tyre. Veçmas çfarë do të rezultojë nga shqyrtimi administrativ, mund të penalizohen me sanksion administrativ për mosbashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kështu që një ridërgim të kërkesës sonë për informacion dhe më pas do të vendosim për çfarë pretendohet në kuadër të këtij denoncimi. Dakord?!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

**6.10.2023  
Ora 13:05**

***RENDI I DITËS***

**“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve regjistruar me nr. 02 ID dhe 03 ID nga zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë ndaj z. Eduart Spahiu, drejtor i Ujësjellësit Kukës dhe disa prej funksionarëve publikë shtetëror për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. M. Koja, z. K. Puleri**


**Parti Politike: S’ka prezent!**

**Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri)**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me shqyrtimin administrativ të dy çështjeve të fundit denoncimin numër 02 ID dhe 03 ID të deputetes zonjës Vokshi.

**Znj. M. Koja:** Bëhet fjalë për dy denoncime të zonjës Albana Vokshi i pari ndaj drejtorit të Ujësjellës Kanalizimeve, Kukës i cili sipas pretendimeve më datë 24.09.2023, ditën e zgjedhjeve në Kukës, ka qëndruar në ambientet e QV Mamëz, Kolsh, duke kontrolluar dhe intimiduar votuesit, nëpërmjet sistemit të patronazhimit që ka Partia Socialiste. Në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë vënë disa foto, por nëpërmjet tyre është e pamundur të provohet qartësisht ekzistenca e shkeljes së pretenduar. Pra, intimidimi, bërja presion votuesve për të votuar në një mënyrë të caktuar. Për aq prova dhe fakte që paraqiten nuk e provojmë shkeljen e

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.6.10.2023*

pretenduar nga zonja Vokshi. Në të njejtën logjikë është dhe denoncimi i dytë i cili është ndaj disa funksionarëve publikë shtetërorë në Bashkinë Kukës, ku në mënyrë të përgjithshme janë përmendur: drejtorë shkollash, apo hipoteke pa cilësuar se kush, të postës, doganierë etj., të cilët janë fotografuar nga qytetarë në qendra votimi, të cilët njësoj si në rastin e parë, qëndrojnë aty për të bërë presion për të votuar, zgjedhësve. Edhe në rastin e dytë janë vetëm disa foto dhe nuk provohet qartësisht ekzistenca e këtyre personave, nëse janë prova të tjera video, apo filmike duke bërë presion votesve për të votuar në një mënyrë të caktuar. Në këto kushte, ne propozojmë pushimin e procedimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes.

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë, meqenëse nga çfarë është pretenduar, nuk mund të provohet në lidhje me këto denoncime dhe në fakt natyra e shkeljeve që pretendohet janë jo të karakterit në fakt administrativ, por të karakterit penal, sikurse është intymindimi i zgjedhësve, apo të tjera si këto, ne do të vendosim pushimin administrativ pa propozuar vendosjen e sanksioneve për të dy këto raste.

Faleminderit!

Çështje të tjera në rend dite nuk kemi! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 798**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

